

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org: \_\_\_\_\_ Nr. Prot: \_\_\_\_\_  
Org. Jedinica: 01 Broj Prot: 05-123  
Org Unit: \_\_\_\_\_ Prot.No: \_\_\_\_\_  
Nr. i faqeve: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_  
Br. stranica: -1- Datum: 12/01/2021  
No. pages: \_\_\_\_\_ Date: \_\_\_\_\_  
Prishtinë / a



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER  
LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Njësia: \_\_\_\_\_ Nr. Prot.: \_\_\_\_\_  
Unit: ZK Prot. No.: 04/2021  
Jedinica: \_\_\_\_\_ Br. Prot.: \_\_\_\_\_  
Nr. i faqeve: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_  
No. of pages: -01- Datum: 12.01.2021  
Br. stranica: \_\_\_\_\_ Date: \_\_\_\_\_  
Prishtinë/a

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

**PËR:** z. Avdullah Hoti- U.D. i Kryeministrit të Qeverisë së Rpublikës së Kosovës  
z. Armend Zemaj – U.D. i Ministrit të Shëndetësisë

**NGA:** Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci – Kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës

**LËNDA:** Kërkesë për iniciimin e procedurave për draftimin e aktit normativ për kompensimin e familjeve të mjekëve dhe punëtorëve tjerë shëndetësor që humbin jetën në krye të detyrës

**Datë:** 12 janar 2021

I nderuar Kryeministër Hoti,  
I nderuar Ministër Zemaj,

Si rrjedhojë e situatës me pandeminë COVID-19, ku një numër i konsiderueshëm i mjekëve dhe punëtorëve tjerë shëndetësor kanë humbur jetën në shërbim të pacientëve si rezultat i infektimit me virusin SARS Cov-2, dhe të cilët duke qenë mbajtës të familjes apo kryefamiljarë me vdekjen e tyre u është rrezikuar drejtpërdrejtë mirëqenia e anëtarëve të familjeve të tyre.

Andaj, bazuar në Nenin 10 paragraf 1 me nënparagraf 1.5 dhe 1.6 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës, Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës si dhe bazuar në praktikën e institucioneve tjera, përkatësisht Institucionit të Policisë së Shtetit të cilët përmes nxjerrjes së një akti normativ mundësojnë kompensimin e familjarëve të zyrtarëve policor të rënë në detyrë, Oda e Mjekëve të Kosovës përmes kësaj shkrese kërkon nga Ju, që të ndërmerri veprime të nevojshme për iniciimin e procedurave për draftimin e një akti normativ për kompensimin e familjeve të mjekëve që humbin jetën në krye të detyrës.

OMK konsideron se me këtë iniciativë ligjore do ti sigurohej një jetë e dinjitetshme familjeve të mjekëve të cilët nuk kursyen jetën e tyre për t'i shërbyer dhe shpëtuar jetën e pacientëve, sidomos në kohën e pandemisë.

Duke shpresuar se kërkesa e adresuar nga ne do të has në mirëkuptimin tuaj dhe do të ndërmerri hapa konkret lidhur me çështjen, ne Ju njoftojmë se jemi të gatshëm të kontribuojmë për draftimin e një akti normativ përkatës që rregullon këtë çështje!

Me respekt,  
Kryetari i OMK-së  
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci

Prishtinë, 12 janar 2021

